



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1001 Prot.

Tiranë, më datë 14.07.2021

VENDIM
Nr. 365, datë 14.07.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.07.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Studim i parkut ekzistues dhe propozim i një sheshi polifunksional parkim nëntokësor 4 kate nën tokë + 1 kat objekt shërbimi mbi tokë në funksion të sheshit të ri”, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike B të qytetit të Lezhës, me aplikues ARCHITECTURE STUDIO MAX XII, zhvillues EUROCOMPANY dhe Konceptin e Sondazheve Arkeologjike realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Skënder Muçaj;
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor me objekt “Studim i parkut ekzistues dhe propozim i një sheshi polifunksional, parkim nëntokësor 4 kate nën tokë + 1 kat objekt shërbimi mbi tokë në funksion të sheshit të ri”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
 4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

